

L I G J
Nr.9114, datë 24.7.2003

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR
SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 13 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 3, pas fjalëve "Instituti të Sigurimeve Shoqërore" shtohen fjalët "ose Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas fazave, që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".
2. Në pikën 4, fjalët "3 vjetëve" bëhen "5 vjetëve".

Neni 2

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 16
Sanksionet

1. Kamatëvonesat

Nëse kontributet nuk paguhen në afatet e përcaktuara në këtë ligj, personi juridik e fizik përgjegjës do të paguajë kamatëvonesë, që llogariten mbi shumën e kontributeve të papaguara, nga data në të cilën pagesa ka qenë e detyrueshme deri në datën në të cilën pagesa kryhet.

Kamatëvonesë për kontributet e paguara jashtë afateve të caktuara është 2 për qind për muajin e parë të vonesës dhe 1,3 për qind për çdo muaj tjetër.

Kamatëvonesë minimale e zbatuar nuk mund të jetë më e vogël se 5 për qind e detyrimit.

Kamatëvonesat do të deklarohen nga personi juridik ose fizik në deklaratën e muajit pasardhës, kur ka lindur detyrimi dhe do të paguhen brenda datës së përcaktuar për pagesën e kontributeve. Nëse kamatëvonesat nuk deklarohen dhe paguhen në muajin pasardhës, organet e ngarkuara për mbledhjen e kontributeve, lëshojnë një vlerësim për shumën e kamatëvonesës, i cili i njoftohet personit juridik ose fizik.

2. Gjjobat

Kur nuk përbëjnë vepër penale, përveç pagesës së kontributit, shkeljet e mëposhtme dënohen me gjobë:

a) për mosregjistrimin e veprimtarisë ekonomike në organet përgjegjëse për mbledhjen e kontributeve, punëdhënësi dënohet me gjobë 60 000 lekë, ndërsa i vetëpunësuar i me gjobë 20 000 lekë;

b) për paraqitjen me vonesë për regjistrimin e veprimtarisë ekonomike në organet përgjegjëse për mbledhjen e kontributeve, punëdhënësi dënohet me gjobë 30 000 lekë, ndërsa i vetëpunësuar i me gjobë 10 000 lekë;

c) për vonesë në dorëzimin e dokumentacionit të përcaktuar nga organet përgjegjëse për mbledhjen e kontributeve, punëdhënësi dënohet me gjobë 10 për qind të kontributit të deklaruar me

vonesë, por jo më pak se 10 000 lekë, ndërsa i vetëpunësuar 10 000 lekë;

ç) kur në dokumentacionin e paraqitur ka të dhëna të pasakta për të pakësuar, në këtë mënyrë, shumën e kontributeve, punëdhënësi dënohet me gjobë 50 000 lekë;

d) kur nuk e ka paguar kontributin për sigurimet shoqërore, megjithëse e ka mbajtur nga paga e të punësuarit, punëdhënësi dënohet me gjobë 50 000 lekë;

dh) kur nuk i mban regjistrimet, në përputhje me procedurat e përcaktuara, punëdhënësi dënohet me gjobë 30 000 lekë.

Gjobat vendosen nga inspektorët e agjencive të Institutit të Sigurimeve Shoqërore."

Neni 3

Në nenin 68, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Të ardhurat, shpenzimet dhe gjendja financiare e fondit të sigurimeve shoqërore auditohen një herë në pesë vjet nga subjekte të specializuara në këtë fushë. Zgjedhja e subjekteve bëhet në përputhje me ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik".

Neni 4

Në fund të pikës 1 të nenit 79 bëhen këto shtesa:

"- të dorëzojë në organet e sigurimeve shoqërore, brenda tremujorit të parë të çdo viti, deklaratën për kontributet e paguara gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, për çdo të punësuar, sipas modelit të miratuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

- të marrë numrin e sigurimeve shoqërore nga agjencia e sigurimeve shoqërore për të punësuarit e rinj."

Neni 5

Në nenin 81, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Paragrafi i parë i këtij neni nuk zbatohet për personat juridikë ose fizikë, të cilët veprimtarinë në fushën e kontributeve e kanë kaluar në organet tatimore."

Neni 6

Pika 1 e nenit 82 ndryshohet si më poshtë:

"1. Të gjitha të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe nga kamatëvonesat e tyre, të mbledhura nga organet tatimore, transferohen në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të organeve në varësi të tij. Procedurat e transferimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3940, datë 19.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**